

ÇDO FËMIJË NË SHKOLLË!

Newsletter nr 11, Mars 2016

Përmbledhje Periodike

Në kuadër të programit “OOSC – Out of School Children”



Nisma “Çdo fëmijë në shkollë” në partneritet me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe UNICEF, zbatohet nga Observatori për të Drejtat e Fëmijëve.

Kjo nismë ka për qëllim monitorimin e situatës aktuale të sistemit arsimor të

Shqipërisë lidhur me çështjen e fëmijëve që kanë braktisur shkollën dhe ata që rrezikojnë ta braktisin. Kjo nismë synon nxitjen dhe mbikëqyrjen e procesit të komunikimit dhe raportimit mbi fëmijët në rrezik braktisjeje të shkollës dhe përthithjen e fëmijëve jashtë shkolle.

Observatori për të Drejtat e Fëmijëve, një nismë e UNICEF Shqipëri dhe partner i UN, ka zhvilluar një mekanizëm që lejon mbledhjen e informacionit në nivel rajoni (Qarku) në lidhje me situatën dhe të drejtat e fëmijëve.

Si pjesë aktive dhe integrale e shoqërisë civile në çdo rajon, Observatori bashkëpunon me aktorë publikë dhe privatë në procesin e mbledhjes sistematike të të dhënave dhe nxjerrjen e raporteve dhe relacioneve informuese në lidhje me të drejtat e fëmijëve, zbatimin e ligjeve në këtë fushë dhe identifikimin e nevojave për përmirësime.

Nisma “Çdo fëmijë në shkollë”

Në kuadër të zbatimit të nismës “Çdo fëmijë në shkollë”, po monitorohet procesi i zbatimit të Urdhërit të përbashkët të Rregullores 3 Ministrore “Për identifikimin dhe rregjistrimin në shkollë të të gjithë fëmijëve të moshës së detyrimit shkollor” në Bashkinë Durrës.

Në konsultim me grupin e punës janë përzgjedhur **10**

shkolla pilot në Bashkinë Durrës, për monitorimin e zbatimit të Rr3M, të cilat janë: Bajram Curri 2, Bedrije Bebeziqi, Demokracia, Eftali Koci, Hasan Koci, Isuf Ferra, Kulle, Kushtrimi i Lirisë, Shkolla e Re, St. Zoot Xhafzotaj.

Arritjet e nismës për periudhën Dhjetor 2015- Shkurt 2016

- ✓ Takim me rrjetin/ grupin e punës për zbatimin e angazhimeve të nismës.
- ✓ Botimi i Urdhërit të përbashkët për miratimin e Rregullores 3 Ministrore “Për identifikimin dhe rregjistrimin në shkollë të të gjithë fëmijëve të moshës së detyrimit shkollor” në Fletoren zyrtare nr 202, datë 25 Nëntor 2015.

Në Website të Observatorit për të Drejtat e Fëmijëve:

http://observator.org.al/wp-content/uploads/2016/02/Rr3M_ne_Fletoren_Zyrtare_nr202_25-Nentor-2015.pdf

Në Website të Qendrës së Botimeve Zyrtare:

http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2015/PDF-2015/202-2015.pdf

- ✓ Realizimi i trajnimeve me përfaqësues të shkollave pilot dhe shkollave të tjera në Durrës sipas Udhëzuesit “Për monitorimin e fëmijëve jashtë arsimor dhe fëmijëve që rrezikojnë të braktisin shkollën”.
- ✓ Nxitja e komunikimit ndërmjet Ministrive dhe Institucioneve vartëse për zbatimin e Rr3M.
- ✓ Nxitja e MSH dhe MB që të nxjerrin listat e fëmijëve në moshë shkolle për t’u rregjistruar në klasë të parë në fillim të këtij viti shkollor- si një nga detyrimet rrjedhëse të zbatimit të Rr3M.
- ✓ Trajnim të përfaqësuesve të DAR/ ZA në të gjithë Shqipërinë në lidhje me udhëzuesin “Për monitorimin e fëmijëve jashtë sistemit arsimor dhe fëmijëve që rrezikojnë të braktisin shkollën”.
- ✓ Hartimi i manualit të një trajnimi të plotë shkollor mbi edukimin cilësor “Garantimi i frekuentimit të rregullt dhe kryerjes së arsimit bazë për çdo fëmijë”.
- ✓ Hartimi i udhëzuesit të mentorimit të praktikave më të mira për t’u shkëmbyer ndërmjet shkollave të ndryshme.
- ✓ Pasqyrimi i Udhëzuesit të zberthyer më në detaje për rolet dhe përgjegjësitë e të gjithë aktorëve të përfshirë në këtë çështje në Website të Ministrive.
- ✓ Kryqëzimi i Listave të fëmijëve që duhet të ndjekin klasën e parë nga MAS që vijnë nga burimet:
 - Shkolla;
 - Ministria e Punëve të Brendshme;
 - Ministria e Shëndetësisë;
 - Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.
- ✓ Lista e treguesve që do të gjenerohen në sistemin EMIS.
- ✓ Monitorim i zbatimit të Rregullores 3 Ministrore në 10 shkollat pilot në Durrës.

Angazhimet: Mars- Prill 2016

- Trajnim i aktorëve veprues brenda në shkollë për braktisjen dhe fëmijët jashtë shkolle.
- Workshope me grupet e punës dhe grupet e brendshme të shkollës për çështjen e fëmijëve jashtë shkolle.
- Monitorimi i zbatimit të Rr3M nga Ministrinë dhe institucionet përgjegjëse;
- Konferencë kombëtare mbi fëmijët jashtë shkolle.

Lista e Shkurtimeve

UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
UN	Kombet e Bashkuara
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sportit
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
DAR	Drejtoria Arsimore Rajonale
ZA	Zyra Arsimore
EMIS	Sistemi për Menaxhimin e Informacionit Arsimor
Rr3M	Rregullore 3 Ministrore



OBSERVATORI PËR TË DREJTAT

E FËMIJËVE

Bulevardi "Bajram Curri", Pall "Agimi", Shk 5,
Ap 81, Tiranë

Tel: 00355 4 258 987

E-mail: info@observator.org.al

Web: www.observator.org.al